

Këshilltarët shpërfillin debatin publik për buxhetin

Arian Duriqi

LIPJAN, 26 GUSHT – Diskutimet publike për kornizën afatmesme buxhetore të Lipjanit 2015-2017 janë shpërfillur nga kuvendarët e kësaj komune, derisa janë vetë këshilltarët lipjanas që në fund do të bëjnë amin për kalim të këtij buxheti. Për këtë punë ka pasur edhe reagime, ndërsa shoqëria civile që merret me monitorim institucionesh në këtë komunë praninë e vogël të kuvendarëve nëpër diskutime publike për buxhetin e quan të paarsyeshme. Në diskutimet për buxhetin që janë mbajtur së fundi në shumë lokalitete të mëdha të Komunës dhe në vetë Lipjanin, ndërkaq, thuhet se ka pasur prani shumë të vogël këshilltarësh.

Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv i OJQ YAHR, ka deklaruar se këshilltarët nuk do të duhej së paku në këto takime të shfaqnin mosinteresim për pjesëmarrje. Sipas tij, ata janë përfaqësues interesash të qytetarëve të kësaj komune dhe duhet njëherësh t'i mbrojnë këto interesa edhe kur bëhet fjalë për buxhetin komunal.

"Këshilltarët është dashur të ishin në numër të madh nëpër takimet ku është diskutuar buxheti e jo vetëm nga një prej tyre. Prandaj, përpjegjësia e këshilltarëve komunalë ndaj qytetarëve është një veprim jo i ndershëm, për arsye se ata janë zgjedhur për të përfaqësuar interesat e qytetarëve, e jo interesat personale", ka thënë Krasniqi.

Ai, ndërkaq, u ka bërë thirrje këshilltarëve të KK-së që në të ardhmen të jenë aktivë nëpër takime të tilla dhe që angazhimin e tyre ta dëshmojnë edhe në mbledhjet e KK-së. "Komuna e Lipjanit dhe vetë KK-



Bekim Krasniqi, drejtor ekzekutiv i OJQ YAHR, ka deklaruar se këshilltarët nuk do të duhej së paku në këto takime të shfaqnin mosinteresim për pjesëmarrje. Sipas tij, ata janë përfaqësues interesash të qytetarëve të kësaj komune dhe duhet njëherësh t'i mbrojnë këto interesa edhe kur bëhet fjalë për buxhetin komunal

ja mund ta kenë një performancë më të mirë vetëm në qoftë se këshilltarët janë aktivë në të gjithë pikat që diskutohen, ndryshe nuk mund të rregullohet jetesa e qytetarëve", ka thënë Krasniqi.

Takime për buxhetin janë mbajtur në shumë vende rurale përfshirë: Magurën, Gadimen, Dobrajën, ndërsa një takim është mbajtur edhe në Lipjan. Për më tepër, projektbuxheti është dokumenti më i rëndësishëm që prek direkt jetesën e qytetarëve, ndërsa mungesa e këshilltarëve në takime të tilla është vështirë e justifikueshme edhe për ata kandidatë që ishin në garë për një ulëse në KK.

"Takimi konsultativ për buxhetin është rrugë që çon drejt finalizimit të një dokumenti të rëndësishëm, që do të dalë edhe në KK për miratim. Prandaj këshilltarët është dashur të ishin kudo në takime për ta disku-

tuar buxhetin", ka thënë ish-kandidati për KK, Milazim Lubovci.

Ndërkohë që autoritetet komunale të Lipjanit nuk kanë folur shumë për pjesëmarrjen apo jo të qytetarëve dhe të këshilltarëve në takime të tilla, por kanë thënë gjatë kohës sa ishin mbajtur diskutimet ishin elaboruar me përpikëri projeksionet buxhetore për periudhën 2015-2017, ndërsa, njëherësh edhe janë marrë rekomandimet e qytetarëve. Zëdhënësi i Lipjanit, Alban Nuredini, ka deklaruar se më 14 gusht ka përfunduar me sukses dëgjimi publik lidhur me projeksionet buxhetore për 2015-2017, ndërsa në dëgjime ishin përfshirë 54 lokacione, përkatësisht 13 qendra shkollore. Ai ka siguruar se gjatë diskutimeve janë trajtuar me kujdes të gjitha rekomandimet e dala nga qytetarët.